



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 676/2 prot

Datë 01.04.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Carpathia Albania” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-14273-12-07-2021, me objekt “*Loti 1 Cefepime*”, me fond limit 700,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.12.2021 nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “Carpathia Albania” SHPK
Adresa: Rr. “Pavarësia”, Nd.1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Spitali Rajonal Durrës
Adresa: Lagjja nr.8, Rr. “Aleksabdër Goga”, Durrës.

Në datën 01.04.2022, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është protokolluar ankesa me nr. 676 e operatorit ekonomik “Carpathia Albania” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-14273-12-07-2021, me objekt “*Loti 1 Cefepime*”, me fond limit 700,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.12.2021 nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Carpathia Albania” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Carpathia Albania” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 676 prot., datë 01.04.2022.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Autorizim tregtimi nga MSHMS datë 24.02.2017 aktualisht është jashtë afatit”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 01.04.2022.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri